



Prishtinë: 19.05.2016
Kodi i ZRRE-së: V_815_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1465_03_16**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **05.04.2016**

në seancën e mbajtur më datë 19 maj 2016, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A. A. me shifër DPR- 40659 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1465_03_16** i datës 17.03.2016.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 05.04.2016 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori A. A. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për këto shkaqe: 1. Konsumatori ka kërkuar që vendimi i atakuar të rishikohet edhe njëherë këtë e bazon në faktin se shpenzimet e energjisë elektrike janë të njëjta me periudhën e vitit 2014 para ndërrimit të njehsorit elektrik si dhe periudhën pas ndërrimit të njehsorit elektrik për vitin 2015.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 07.05.2015 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, dhe gjatë inspektimit kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 63822834, e cila në momentin e inspektimit ka qenë TL=006270 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=002592 kWh (tarifa e ulët).

Gjithashtu është vërtetuar se në bazë të ankesës së konsumatorit, Departamenti për Konsumator në KESCO me datë 15.04.2015 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, si dhe procesverbalin e inspektimit nr. 0535972 e datës 07.05.2015. Në përgjigjen e KESCO-s është theksuar se faturimi është bërë konform rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.

I pakënaqur me përgjigjen e KESCO-së, konsumatori i është drejtuar DMK/ZRRE me ankesë me të cilën ka apeluar përgjigjen e KESCO-së dhe ka kërkuar që t'i shqyrtohen faturat e energjisë elektrike prej periudhës 11/2014 e deri më 03/2015. DMK/ZRRE pas shqyrtimit e ankesës së konsumatorit me datë 17.03.2016 ka marr vendim me të cilën ka refuzuar ankesën e konsumatorit si të papabazuar.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2016 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga ana e konsumatorit A.A. dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vendimit të DMK-së ka vërejtur se organi i shkallës së parë ka bërë gjithë analizat e nevojshme të shpenzimit të energjisë elektrike të evidnetuara në rrjedhën e energjisë së shpenzuar nga konsumatori. Analiza e bërë ka përfshirë krahasimin e shpenzimeve për periudhat e njehsorit elektrik **nr.63822834**, si dhe me njehsorin e vjetër elektrik **nr. 7901905**. Sipas krahasimeve të bëra për periudhën e njëjtë kohore 17 mujore: me njehsorin e ri elektrik **nr. 63822834** prej periudhës 10/2014 deri në periudhën 02/2016 mesatarja mujore e shpenzimit është **862 kWh/muaj**, kurse me njehsorin elektrik **nr.7901905** prej periudhës 10/2012 deri në periudhën 02/2014 mesatarja mujore e shpenzimit është **662 kWh/muaj**, si dhe për periudhën 10/2010 deri në periudhën 02/2012 mesatarja mujore e shpenzimit është **704 kWh/muaj**. Sipas krahasimit të bërë konstatohet se konsumatori ka ndryshim edhe në shpenzimin e energjisë elektrike për periudhën kontestuese krahasuar me periudhën e më vonshme me njehsorin e ri elektrik **nr. 63822834** ku: për periudhën 11/2015 - 02/2016 mesatarja mujore e shpenzimit është **678 kWh/muaj**, kurse për periudhën 11/2014 - 02/2015 mesatarja mujore e shpenzimit është **1,185 kWh/muaj**.

Bordi ka konstatuar se organi i shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në menyrë të drejtë dhe të plotë pasi që janë analizuar në detaje rrjedhat e energjisë elektrike për ketë pikë matëse dhe është vërtetuar se KESCO ka aplikuar drejt dispozitat e nenit 23 paragrafi 1 dhe 2 të Rregulles për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.



Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit A. A.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.